



GRUAJA në

VENDIMMARRJE

Botimi i këtij materiali është mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë. Opinione, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit

EDITORIAL



Një zë për gratë

MIRELA SULA *

Vetëm pak ditë na ndajnë nga zgjedhjet elektorale dhe jeta jonë e përditshme është e mbushur me slogane, premtime, thirrje e mesazhe pa fund që vijnë nga forca të ndryshme politike. Në fakt, ka muaj që bëhet zhurmë, që ngrihen debate dhe ziejnë probleme që lidhen me këtë fushatë, por çështja më e rrahur dhe shpesh e kontestuar ka qenë ajo e kuotës së vendosur për pjesëmarrjen e grave në parlament. Kjo ka qenë një nga çështjet më të rëndësishme edhe për Rrjetin e Grave "Barazi në Vendimarrje" gjithashtu. Qysh kur filluam të rendisim objektivat e para për këtë rrjet, një iniciativë e pashmangshme ishte edhe lobimi për të promovuar pjesëmarrjen e gruas në vendimarrje. Sapo kishim përfunduar trajnimin një vjeçar nga NDI dhe ndërgjegjësimi filloi t'i shfaqte shenjat e para, duke pretenduar më shumë nga vetja dhe duke besuar se përfshirja e gruas në politikë nuk do të mbetej më "një mollë e ndalueme". Ky është vetëm fillimi ynë, një iniciativë që mbledh sëbashku shumë zëra, një lëvizje që ka filluar të ndryshojë pikë së pari perceptimin rreth aftësive tona. Këto dy suplemente që na krijuan mundësinë për të shprehur hapur mendimet, lidhur me vizionin që Rrjeti ynë ka për të ardhmen e gruas, dhe vendin që asaj i takon, nuk mbarojnë këtu. Ne vazhdimisht do ta gjejmë mënyrën për të ndarë sëbashku idetë, opinionet, problemet dhe shqetësimet që do të ngrihen për çështjet dhe të drejtat e grave. Këto dy suplemente ishin një thirrje jo vetëm për burrat që t'i pranojnë gratë si partnere të barabarta krahas tyre, por sidomos për vetë gratë që të kenë më shumë besim në vete dhe të votojnë me 28 qershor për të realizuar atë çfarë ende nuk kanë mundur.

* Koordinatorë kombëtare e Rrjetit të Grave "Barazi në Vendimarrje"



SASHA PAJEVIÇ

GRATË do të sjellin erën e ndryshimit

Dot ë lexoni



Pushteti nuk është ekskluzivitet i burrave

Faqe 26



Futja e gruas në Parlament, nuk është një dhuratë

Faqe 27



Gara elektorale ka nevojë për mendime të kthellëta

Faqe 25



Kuota 30% e grave, privilegj për vetë Parlamentin

Faqe 25



Fletë nga ditari i fushatës

Faqe 28



Kuota 30% nën këndvështrimin tim

Faqe 26



Zgjedhjet dhe Gruaja

Faqe 28



Modeli i lideres së re

Faqe 28

Flet Drejtoresha e NDI në Shqipëri, Sasha Pajević

Gratë do të sjellin erën e ndryshimit në parlamentin e ardhshëm

Drejtoresha e NDI e cila ka tre vjet që punon në Shqipëri, Sasha Pajević, prej kohësh e ka shprehur entuziazmin e saj për forcën dhe potencialin që kanë gratë shqiptare në leadership. NDI ka qenë ndër të parat institucione që ka punuar intensivisht me trajnimet e advokimit të grave në mbarë Shqipërinë. Për dy vite radhazi Sasha Pajević ka udhëtuar qytet më qytet duke takuar dhe njohur nga afër problemet e gruas në Shqipëri. Me një energji të pashtershme dhe me aftësitë e saj Sasha Pajević ka arritur që të bëjë të realizueshme programe që kanë sjellë jo vetëm risi por edhe rezultate të drejtpërdrejta në dobi të grave shqiptare. Kur e pyesim për të realizuar këtë intervistë ajo tregohet shumë modeste, duke dashur që të nxjerrë në pah vlerat e grave me të cilat ka punuar, por ama më shumë se çdo gjë flet puna e saj reale. Pas tre vitesh angazhim intensiv ajo ka pse të ndihet krenare sepse anekënd Shqipërisë ka gra të cilat e njohin dhe e çmojnë për kontributin që ka dhënë në promovimin e gruas shqiptare në politikë dhe vendimmarrje. Por misioni i saj nuk mbaron këtu. Në këtë intervistë ajo tregon jo vetëm për punën e deritanishme por edhe për planet që ka NDI në të ardhmen lidhur me çështjet e rëndësishme të grave siç është dhe vendimmarrja.

Keni 3 vite që jepni kontributin tuaj në Shqipëri duke promovuar përfshirjen e grave në vendimmarrje: Jeni e kënaqur me arritjet?

Sigurisht që unë jam shumë e kënaqur që do të shohim më shumë gra në parlamentin e ardhshëm dhe si rrjedhim më shumë gra të angazhuara në instanca qeverisëse dhe vendimmarrje. Gjithashtu shpresoj që koalicioni që do të formojë qeverinë pas këtyre zgjedhjeve të krijojë hapësira më të gjera për vajzat dhe gratë në vende kyçe në administratë. Në 18 vitet e fundit, gratë Shqiptare kanë punuar vërtet shumë për të marrë përsipër pjesën e tyre të përgjegjësisë shoqërore. Gratë u bashkuan për të lobuar për të drejtat e tyre dhe si rezultat u adoptua edhe ligji i barazisë gjinore dhe u miratuan amendamentet e kodit të ri zgjedhor megjithëse ato nuk ishin të mjaftueshme për të garantuar një balancë gjinore në parlament. Gratë dhe vajzat duhet të vazhdojnë me këto përpjekje për ta mbajtur çështjen e rolit të gruas në shoqëri në faqet e para të gazetave.

Siç thashë edhe pak më parë, ne jemi të lumtur me progresin e deritanishëm, megjithatë duhet të them se jemi të zhgënjyer me listat e kandidatëve dhe me pozicionimin e grave në këto lista. Duke marrë parasysh angazhimin e deklaruar të partive gjatë viteve të fundit, në pritëm që partitë të ishin shumë më serioze në përpjekjet e tyre për të vendosur gratë në pozicionet fituese në listat e kandidatëve. Në zgjedhjet e fundit lokale dhe gjatë fushatës zgjedhore të këtij viti, gratë kanë punuar shumë për partitë e tyre, duke bërë fushatë çdo ditë, nga mëngjesi

deri në darkë, për të kontaktuar votuesit dhe për të siguruar vota për partitë e tyre. Ato kanë demonstruar se janë të gatshme të punojnë shumë fort për të siguruar suksesin e partive të tyre; dhe për një punë të barabartë duhet të shpërblehesh në mënyrë të barabartë.

Nga NDI janë trajnuar dy grupe grash, pjesëmarrëse nga parti të ndryshme politike dhe nga qytete të ndryshme; dhe një pjesë e mirë e këtyre grave janë candidate. A mendoni se trajnimi i NDI ka qenë një ndikim i fortë për këtë?

Ne jemi të bindur që programet tona patën një influencë pozitive, por - në fund të fundit - ishte angazhimi që gratë kanë treguar që vërtet bëri ndryshimin dhe bëri që ato të vëreheshin nga leadershipi i partisë. Ne jemi krenarë të themi që NDI punoi për një periudhë mbi 18 mujore me mbi 80 gra nga 13 qytete të ndryshme të Shqipërisë dhe 20 nga këto gra janë tashmë në listat e kandidatëve të partive. Por më duhet ta përsëris që, për fat të keq, jo shumë prej tyre do të kenë mundësinë të jenë pjesë e parlamentit të ardhshëm. Trajnimet dhe programet tona patën një ndikim shumë të madh tek gratë duke i motivuar ato, duke u dhënë atyre eksperiencën dhe njohuritë e nevojshme për të kontribuar në mënyrë domethënëse në punën e partive të tyre, dhe - në fund - duke informuar kryesitë e partive mbi potencialin dhe aftësitë e anëtareve brenda strukturave të partisë. Çdo pjesëmarrëse u trajnuar për një periudhë nëntë-mujore dhe pas çdo seance trajnimi ato praktikuan gjërat që mësuan duke realizuar pyetësorë për të gjetur prioritetet e qytetarëve, duke zhvilluar



Drejtoresha e NDI në Shqipëri, Sasha Pajević

Ne jemi të lumtur me progresin e deritanishëm, megjithatë duhet të them se jemi të zhgënjyer me listat e kandidatëve dhe me pozicionimin e grave në këto lista. Duke marrë parasysh angazhimin e deklaruar të partive gjatë viteve të fundit, në pritëm që partitë të ishin shumë më serioze në përpjekjet e tyre për të vendosur gratë në pozicionet fituese në listat e kandidatëve

konferenca për shtyp, duke organizuar fushata advokimi, etj. Pas dhënies së certifikatave grupit të parë të programit tonë, pjesëmarrëset vendosën të organizoheshin dhe të krijonin një organizatë që është tashmë një Rrjet Grash me emrin "Barazi në Vendimmarrje". Pjesëmarrëset e grupit të dytë iu bashkuan këtij rrjeti i cili tashmë po zgjerohet. NDI është në kontakt të vazhdueshëm me anëtarët e rrjetit dhe herë pas herë i këshilloi dhe u jep asistencë atyre. Gjithashtu ne jemi në kontakt të vazh-

dueshëm me leadershipin e partive për t'i njohur ata në lidhje me punën e anëtareve të rrjetit tonë dhe gjithashtu në lidhje me aftësitë dhe njohuritë e tyre.

Nga eksperiencën e deritanishme çfarë mendimi keni për gratë shqiptare: a kanë aftësi për të qenë lidere?

Po pa diskutim që po. Unë mendoj se gratë Shqiptare janë inteligjente, të arsimuara, të zgjuara dhe të talentuara. Ato përmbushin një rol shumë të madh në shoqëri dhe në familje; dhe ato dëshirojnë të kon-

tribuojnë akoma më shumë për të përshpejtuar integrimin e vendit të tyre në pjesën tjetër të botës së zhvilluar. Siç thashë edhe më parë, gratë Shqiptare kanë arritur shumë por ka akoma shumë për të bërë për të përmbushur ambiciet e tyre dhe për t'i bërë partnere të barabarta në vendimmarrje. Jam e sigurt që me më shumë gra në parlamentin e ardhshëm, ne do të fillojmë të shohim një frymë të re në trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve dhe do të fillojë të shfaqet një model i ri i grave politike të suksesshme.

NDI ka qenë promotor dhe mbështetës i krijimit të Rrjetit të Grave "Barazi në Vendimmarrje": A mendoni se ky rrjet është duke u fuqizuar?

Rrjeti ka filluar të përhapet dhe të njihet. Ai tashmë po implementon dy projekte, një të financuar nga Ambasada e SHBA dhe një tjetër në bashkëpunim me një OJF lokale në Kukës i mbështetur nga UNIFEM. Emri i rrjetit është bërë i njohur dhe anëtarët e tij janë të njohura në komunitetet e tyre për aktivitetet që po

Jam e sigurt që me më shumë gra në parlamentin e ardhshëm, ne do të fillojmë të shohim një frymë të re në trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve dhe do të fillojë të shfaqet një model i ri i grave politike të suksesshme

kryejnë dhe angazhimin që po tregojnë. Tashmë edhe në nivel kombëtar, gratë e programit tonë që janë candidate gëzojnë një njohje më të gjerë publike. Prezantimi i rrjetit është bërë edhe në median vizive ku anëtarët e rrjetit, mes tyre edhe candidate kanë folur rreth rolit që duhet të ketë gruaja në shoqëri dhe në vendimmarrje.

Cilat janë disa nga programet e NDI që do të ndërmerren pas zgjedhjeve? A do të vazhdoni të jepni kontributin tuaj sërish në mbështetje të grave?

Ne po bëjmë planifikimin tonë strategjik për aktivitetet e periudhës paszgjedhore. Programet e ardhshme të NDI do synojnë të përfshijnë më shumë njerëz në proceset politike dhe legislative për të krijuar ura më të forta lidhjeve ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve si p.sh parlamentit me zgjedhësit. NDI sigurisht do të vazhdojë të punojë me Rrjetin për periudhën që kemi përpara, duke u fokusuar më shumë në ngritjen e kapaciteteve të vetë rrjetit dhe zgjerimin e tij. Ne po punojmë që rrjeti më vonë të marrë përsipër përgjegjësi më të mëdha dhe të shërbejë si promotor i vërtetë i grave në politikë dhe vendimmarrje. Nëpërmjet rrjetit ne duam gjithashtu të arrijmë më shumë njerëz në komunitete dhe të gjejmë mënyra për të zgjidhur çështjet dhe problemet e qytetarëve duke përmbushur premtimin e demokracisë për një jetë më të mirë.